



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.18/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në konfliktin administrativ të paditësit “A... ve T... - Dega ne Kosovë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti e papërcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur në mungesë të palëve ndërgjyqëse, me datë 13.09.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit A... ve T... - Dega ne Kosovë, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Vendimi nr.432/2019 i datës 08.11.2019, i ATK-së Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me datë 06.12.2019 ka ushtruar padi në gjykatë për anulimin e vendimit të ATK-së nr. 432/2019 të datës 13.09.2019 për shkak të siç kuptohet nga padia, shkeljeve thelbësore të Ligjit për Statusin, Imunitetet dhe privilegjet e Misioneve Diplomatike, Konusllore dhe Personelin e Kosovës dhe Praninë ndërkombëtare Ushtarake si dhe Personelin e saj, Ligjit për Plotësim Ndryshimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Ligjit për Procedurën Administrative, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Tutje paditësi deklaron se me raportin e kontrollit biznesi është

ngarkuar me qarkullim shtese në vlerë prej 17,926.34€ dhe ulje te kreditimit të TVSH-së në vlerë prej 6,282.01€. Biznesi është ndëshkuar nga Zyra për Gjoba dhe ndëshkime Administrative me ndëshkim në vlerë prej 1,570.50€ bazuar në nenin 52 pika 1.2 të ligjit 03/L-222 dhe dy gjoba mandatorë nga 1,000.00€ bazuar në nenin 53.2.4 të Ligjit 03/L-222. Për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale-juridike, tatimpaguesi brenda afatit ligjor kundër raportit të kontrollit të datës 15.08.2019 dhe Vendimit nga Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative nr.prot. ... të datës 15.08.2019. Tutje ATK-ja përmes vendimit kontestues nr.432/2019 të datës 08.11.2019 ka vendosur që të ndryshohet vendimi nga ZGJONA nr.1442/2019, respektivisht paditësi të lirohet nga ndëshkimi për mos krijim dhe mos mbajtje të dokumentacionit për periudhën për periudhën 07/2019, ndërsa ndëshkimet tjera vërtetohen si të bazuara. Mbetet në fuqi vlerësimi i kontrollit për trajtimin si furnizime te tatueshme të mjeteve themelore, respektivisht Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtese për zbritje te kreditimit në vlerë prej 6,282.10€. vlerësimi i dhënë nuk është korrekt për shkak të shkeljeve thelbësore të Ligjit për Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve Diplomatike, Konsulore dhe Personelin e Kosovës dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake si dhe Personelin e saj, ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe ligjit për Procedurën Administrative dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Paditësi bizneseve vendore iu ka shitur vetura, kamion për të cilat paditësi nuk ka paguar doganë dhe TVSH sepse kanë qenë të importuara si import i përkohshëm më IM4 dhe IM5. Nga Qendra e Regjistrimit të Automjeteve paditësi e ka marr njoftimin se këto vetura nuk mund te regjistrohen pa u zhdoganuar. Si rrjedhojë paditësi në këtë rast është eksportues, ndërsa blerësi është importues i cili do të kryej doganimin. Shitja e veturave ne TVSH në këtë rast është e pamundur si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë procedural, sepse klienti do t'i kthej ato sapo të shtohet TVSH-ja, dhe si të tilla do të mbesin në stok si mjete themelore të biznesit. Prandaj është plotësisht i gabuar konstatimi në raportin e kontrollit të organit të paditur se në këtë çështje juridike fiskale kemi të bëjmë me mos deklarim apo mos mbajtje të librave. Tutje paditësi i propozon gjykatës kompetente të anuloj vendimin e kundërshtuar si të kundërligjshëm, përkatësisht të vendos si në petiumin e kësaj padie. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 15.01.2021 i kundërshton pretendimet e paraqitura në padi si të pabazuara në ligj dhe vlerëson se vendimi i Departamentit të Ankesave me nr.432/2019 i datës 08.11.2019 është i bazuar në prova konkrete dhe dispozita ligjore. Lidhur me pikën e parë kontestuese që ka të bëjë me ndëshkimet për periudhat tatimore 06/2018 dhe 09/2017 të lëshuara nga zgjona për mos mbajtje dhe krijim të regjistrimeve ashtu siç kërkohet me nenin 53 paragrafi 2.4 të ligjit 03/L-222, ATK konstaton se deri te këto ndëshkime ka ardhur pasi që paditësi nuk ka evidentuar në libër të shitjes faturat e shitjes ashtu siç kërkohet me nenin 13 të Ligjit 03/L-222, neni 17 paragrafi 4, nën paragrafi 4.2 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 e cila dispozitë parasheh “*Libri i shitjeve në të cilin regjistrohen të gjitha shitjet dhe kthimet*”. Po ashtu lidhur me pretendimin e paditësit se nuk mund të vlerësohen ndëshkimet pasi të hyrat e tij nuk janë objekt i tatuarjes sipas Ligjit nr.03/L-033, ATK ka konstatuar se është i pabazuar pretendimi i paditësit sepse përderisa paditësi është i regjistruar në TVSH në Kosovës dhe të njëjtit i njihet e drejta e kreditimit të TVSH-së, Rimbursimi sipas neneve 36 dhe 40 të Ligjit nr.05/L-037 i njëjti ka obligim të mbajtjes së dokumentacionit sipas legjislacionit tatimor. Edhe pse paditësi të hyrat që i krijon nga KFOR-i trajtohen si furnizime të përjashtuara me të drejtën e kreditimit sipas ligjit nuk është bazë për të ndryshuar vendimin e Zgjona-s për ndëshkimet administrative. Pretendimi i paditësit se ky rast duhet të trajtohet njëjtë si vendimi i DA nr.208/2014 i datës 21.07.2014 është i pabazuar, sepse në vendimin e cekur ka qenë kontestues ndëshkimi administrativ për mos raportim të blerjeve mbi 500.00€ sipas nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-222 e jo për mos mbajtje të regjistrimeve dhe krijimit të regjistrave sipas rastit konkret. Ndërsa sa i përket kontestit në lidhje me shitjet e mjeteve themelore për bizneset vendore dhe trajtimi i tyre nga ana e kontrollit si Furnizime te Tatueshme, ATK-ja k konstatuar se në rastin konkret paditësi ka bërë furnizim të mallit (asetet), dhe përderisa ka bërë shitje për bizneset vendore brenda Kosovës, furnizimi i tillë i ka plotësuar kriteret për tu njohur si furnizim i tatueshëm sipas nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit 05/L-037 për TVSH, sepse në rastin konkret është bërë furnizimi i mallrave për konsideratë brenda territorit të Kosovës nga personi i tatueshëm. Pretendimi i paditësit se mjetet kanë qenë nën regjimet doganore IM4 dhe IM5 dhe për të njëjtat nga paditësi nuk janë paguar obligimet doganore dhe TVSH-ja në blerje dhe në këtë rast paditësi duhet të konsiderohet si eksportues, është i pabazuar sepse sipas nenit 19 paragrafi

1 të ligjit nr.05/L-035 “Kur mallrat nuk janë dërguar ose e transportuar, vendi i furnizimit është vendi ku janë vendosur mallrat në momentin kur është bërë furnizimi”, andaj vlerësimi i kontrollit për trajtimin e këtyre mallrave si furnizime te tatueshme është plotësisht i bazuar në dispozitat e legjislacionit tatimor. ATK-ja mbi bazën e fakteve të paraqitura më lartë i propozon gjykatës që të marr aktgjykim me të cilin refuzohet padia e paditësit dhe aprovohet vendimi kontestues. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ komfor dispozitave të nenit 41 të LKA-së për arsye se paditësi edhe pse e ka pranuar ftesën për seancë në mënyrë të rregullt, pra në adresën e cekur sikurse në padi, i njëjti nuk ka qenë prezent dhe nuk e ka arsyetuar mosardhjen (provë fletë kthesa e datës 02.09.2022). Ndërsa e paditura përmes parashtresës së datës 08.09.2022 e ka njoftuar gjykatën se nuk mund të prezantoj në këtë seancë dhe ka kërkuar që të vepohet konform nenit 38 paragrafi të LKA-së (provë: Parashtresa e datës 08.09.2022 nga ATK).

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 13.09.2022, ka administruar provat dhe atë: Vendimet 208/2014 i datës 21.07.2014, 432/2019 i datës 08.11.2019, 1442/2019 i datës 15.08.2019, Njoftim –Vlerësimet e datës 15.08.2019, Ankesa e ushtruar në ATK e datës 11.09.2019, Raporti i Kontrollit i datës 15.08.2019, Përgjigja në padi e datës 15.01.2021, Faturat nr. ..., nr. ..., nr. ..., nr. ..., nr. ..., nr. ..., nr. ..., nr. ..., nr. ... (e padukshme), nr. ..., nr.4-007, nr.4-272, nr.4-306, nr.4-273, nr.4-380, nr.4-379, nr.4-378, nr.4-376, nr.4-384, nr. ..., nr. ..., nr. ..., nr. ..., nr. ..., nr. ..., nr. ..., DUD-at ..., ..., ..., ... dhe ..., Historia e librit të shitjes për vitin 2017 dhe 2019, tabela gjendja e borxheve së bashku me tabelën borxhi i falur i datës së printimit 01.11.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së),

dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Departamenti i Ankesave-ATK, e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit ku në pikën II, të dispozitivit të vendimit ka ndryshuar vendimin e Zgjona-s nr. ..., respektivisht paditësin e ka liruar nga ndëshkimi për mos krijim dhe mos mbajtje të dokumentacionit për periudhën 03/2019 në vlerë prej 1,000.00€ dhe ka vërtetuar si të bazuara ndëshkimet për mos krijim dhe mos mbajtje të dokumentacionit për periudhat 09/2017 dhe 06/2018 në vlerë prej 2,000.00€, ndërsa në pikën III të dispozitivit të vendimi kontestues ka lënë në fuqi vlerësimin e kontrollit për trajtim si furnizime të tatueshme të mjeteve themelore, respektivisht Njoftim rivlerësimet e tatimit shtesë për zbritje të kreditimit në vlerë prej 6,282.01€.

E paditura në raportin e kontrollit ka gjetur se paditësi nuk ka evidentuar në Libër të Shitjes, për periudhat kontestuese, faturat e shitjeve, andaj është vlerësuar se paditësi nuk ka krijuar regjistra të sakta sipas nenit 13 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nenin 17, paragrafi 4, nën paragrafi 4.2 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 për zbatimin e Ligjit 03/L-222 e cila dispozitë parasheh “*libri i shitjeve në të cilin regjistrohet të gjitha shitjet*”. Pretendimit të paditësit se të hyrat e tij nuk janë objekt i tatuarjes sipas ligjit 03/L-033 për Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve Diplomatike, Konsullore dhe Personelin e Kosovës dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake si dhe Personelin e saj, e paditura në aktvendimin kontestues i është përgjigjur duke konstatuar faktin se përderisa tatimpaguesi është i regjistruar për TVSH në Kosovë dhe të njëjtit i njihet e drejta e kreditimit të TVSH-së, rrjedhimisht rimbursimit, sipas neneve 36 deri 40 të Ligjit nr.05/L-037 për TVSH, të njëjtit i lind obligimi i mbajtjes dhe krijimit të dokumentacionit konform dispozitave ligjore. Tutje ATK-ja në vendimin kontestues, shitjen e mjeteve themelore për bizneset vendore të trajtuara nga kontrolli si Furnizim të Mallrave e ka arsyetuar me faktin se përderisa paditësi ka bërë shitje për bizneset vendore brenda Kosovës, furnizimi i tillë i ka plotësuar kriteret për tu njohur si furnizim i tatueshëm sipas Nenit 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i Ligjit 05/L-037 për TVSH, sepse në rastin konkret është bërë furnizim i mallrave për konsideratë brenda territorit të Kosovës nga

personi i tatueshëm që vepron si i tillë. Ndërsa për pretendimin e paditësit se mjetet kanë qenë nën regjimet doganore IM4 dhe IM5 dhe për të njëjtat nga paditësi nuk janë paguar obligimet doganore dhe TVSH-ja në blerje dhe në këtë rast tatimpaguesi duhet të trajtohet si eksportues, e paditura në vendimin kontestues këtë pretendim e ka vërtetuar si të pabazuar duke u mbështetur në nenin 19, Paragrafi 1 të Ligjit 05/L-037 për TVSH, Vendi i furnizimit të mallrave është vendi ku mallrat janë vendosur, në rastin konkret Kosova, prandaj e ka konsideruar të bazuar vlerësimin e kontrollit.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Pretendimi i paditësi se e paditura me vendimin kontestues ka bërë shkelje thelbësore të Ligjit për Statusin, Imunitetet dhe privilegjet e Misionëve Diplomatike, Konsullore dhe Personelin e Kosovës dhe Praninë ndërkombëtare Ushtarake si dhe Personelin e Saj, përkatësisht nenin 10.6, 10.7 dhe 10.8 të këtij ligji, për gjykatën është i papranuar për arsye se Neni 10.7 i Ligjit 03/L-033 parasheh që *“Kontraktuesit e PNU-së përveç kontraktuesve vendorë nuk do t'i nënshtrohen ligjeve apo rregulloreve vendore përkitazi me licencimin dhe regjistrimin e punëtorëve, bizneseve dhe korporatave”*, që nënkupton se kontraktuesit e PNU-së përveç kontraktuesve vendor nuk do t'i nënshtrohen ligjeve apo rregulloreve vendore sa i përket regjistrimit të punëtorëve, bizneseve dhe korporatave, por jo edhe sa i përket deklarimit të shitjeve në ATK, për arsye se përderisa paditësi është i regjistruar për TVSH në Kosovë dhe rrjedhimisht i njihet e drejta e kreditimit të TVSH-së, lind edhe obligimi i mbajtjes dhe krijimit të dokumentacionit konform dispozitave ligjore në fuqi.

Pretendimin tjetër i paditësit se vendimi kontestues është marr me shkelje thelbësore të nenit 19 paragrafi 2.6 të ligjit 03/L-222, gjykata e vlerëson si të papranueshëm për arsye se e paditura vendimin për ndëshkim e ka mbështetur në nenin 53 paragrafi 2 i cili parasheh *“Çdo person i nga i cili kërkohet të krijojë ose mbajë regjistrime, përfshirë kërkesën për të vendosur numrin fiskal të biznesit në të gjithë kuponët dhe faturat e lëshuara, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe i cili nuk e kryen këtë do t’i nënshtrohet një ndëshkimi administrativ si vijon”* ndërsa nën paragrafi 2.4 parasheh *“tatimpaguesi me qarkullim vjetor prej pesëqind mijë (500,000) dhe më shumë – ndëshkim administrativ prej njëmijë (1,000) Euro”*.

Sa i përket pretendimit të paditësit se vendimi i kundërshtuar ka përdorur standarde të dyfishta për raste të njëjta, pasi që ATK-ja duke vendosur për çështjen administrative tatimore sipas ankesës nr. ... të datës 21.05.2014 ka marr vendimin nr.204/2014 të datës 21.10.2014 – aprovohet ankesa si e bazuar, për gjykatën ky pretendim është i papranueshëm për arsye se obligimi për deklarim për Tatim të Korporatave dallon nga obligimi për deklarim të TVSH-së, Tatimin në Korporata e paguan biznesi e që në rastin konkret biznesi është i liruar nga deklarimi dhe pagesa e këtij tatimi, ndërsa TVSH e paguan konsumatori i fundi, me ç’rast lind edhe obligimi për deklarim në momentin e regjistrimit të biznesit në TVSH.

Edhe pretendimi tjetër i paditësit, sa i përket shitjeve të veturave dhe kamionëve bizneseve vendore, ku sipas paditësit këto shitje duhet të trajtohen si eksporte pasi që janë importe me regjim IM4 dhe IM5 për të cilat nuk është paguar doganë dhe TVSH, për gjykatën është i papranueshëm për faktin se paditësi është biznes i regjistruar në Kosovë dhe si i tillë nuk mund të jetë në të njëjtën kohë edhe importues me regjim IM4 dhe IM5 edhe eksportues i të njëjtave mjete, rrjedhimisht nuk konsiderohet eksport shitja e mjeteve të ndodhura brenda territorit të Kosovës e të shitura në Kosovë. Neni 19 paragrafi 1 i Ligjit 05/L-037 për TVSH parasheh që Vendi i Furnizimit të Mallrave është vendi ku mallrat janë vendosur, në rastin konkret Kosova, andaj është i bazuar vlerësimi i vendimit kontestues se furnizimi i tillë ia ka plotësuar kriteret për tu njohur si furnizim i tatueshëm sipas nenit 3, Paragrafi 1, nen paragrafi 1.1 i Ligjit nr.05/L-037 për TVSH.

Ligji 03/L-222 paragrafi 2 i nenit 19 ” *Vlerësimi i Drejtorit të Përgjithshëm do të bëhet sipas gjykimit të tij ose saj më të mirë dhe do të bazohet në të gjitha provat që ai ose ajo ka në dispozicion, përfshirë: 2.1. librat, regjistrimet, kuponët, faturat, ose informatat tjera përkatëse të tatimpaguesit; 2.2. librat, regjistrimet, kuponët, faturat, ose informatat tjera përkatëse të personave të tretë; 2.3. informatat nga personat të cilët mund të verifikojnë saktësinë e deklaratave, librave dhe regjistrimeve të tatimpaguesit, 2.4. informata të tjera objektive rreth të ardhurave ose shitblerjeve të tatimpaguesit lidhur me detyrimin e tij. 2.5. informatat e siguruara gjatë vizitave tek tatimpaguesit sikurse është paraparë në paragrafin 1 të nenit 14 të këtij ligji; 17 2.6. aplikimin e këtij Ligji dhe/apo ligjet e aplikueshme të tatimeve në të ardhura apo TVSh në Kosovë”*. Ndërsa neni 19 paragrafi 6 i Ligjit 03/L-111 thotë “*Tatimpaguesi ka barrën e provës lidhur me të provuarit se kryerja e ndonjë vlerësimi nga Drejtori i Përgjithshëm është e gabuar dhe barrën për të provuar se shuma e ndonjë vlerësimi të tillë është e pasaktë”*”.

Neni 43, par 1. i LKA-së, “*Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative*”, andaj paditësi në këtë konflikt administrative ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tij në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të ankesës. .

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi në pajtim me nenin 64 të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, pasi që sipas këtij neni në konflikt administrativ secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Departamenti Fiskal / Dhomat e Shkallës së Parë

KF.nr.18/2022, datë 13.09.2022

Bashkëpunëtori Profesional

Visar GASHI

Gj y q t a r i

Fisnik NULI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.